



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 126, datë 15.03.2023

PËR

**PËRFUNDIMIN PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS SË
VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT
2017-2019, PËR GJYQTARIN {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 15.03.2023, si u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja znj. Yllka Rupa dhe pasi shqyrtoi propozimin për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...},

VËREN:

I. FAKTET E ÇËSHTJES DHE PROCEDURA E ZHVILLUAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parashikimet e nenit 85 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe vendimin nr. 645 datë 23.12.2020 “Programi i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2021”, me vendimin nr. 371, datë 13.09.2022, ka vendosur fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2017-2019. Me këtë vendim, pas shortit të realizuar, janë përzgjedhur vlerësuesit, relatore znj. Yllka Rupa dhe nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

Në datën 14.09.2022, në bazë të neneve 85 dhe 89 të Ligjit për Statusin, gjyqtari është njoftuar nëpërmjet postës elektronike për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019, vlerësuesit e përzgjedhur në bazë të shortit dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tyre ose të çdo anëtari të Këshillit. Në datën 14.09.2022, gjyqtari, nëpërmjet postës elektronike ka konfirmuar marrjen e njoftimit dhe ka shprehur dakordësinë për vlerësuesit e përcaktuar.

Me qëllim fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve sipas programit të miratuar me vendimin nr. 645 datë 23.12.2020, në referim të nenit 90 dhe 91 të Ligjit nr.96/2016 dhe nenit 11 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka njoftuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi dërgimin e të dhënave statistikore për periudhën e vlerësimit 1 Janar 2017 deri në 31 Dhjetor 2019 për gjyqtarin {...}.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet postës elektronike ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në format elektronik, të dhënat statistikore për periudhën e vlerësimit të gjyqtarit {...}, duke plotësuar tabelat për secilën kategori çështjesh, si dhe tabelën përmbledhëse.¹

Në datën 27.09.2022, gjyqtarit {...} i është dërguar nëpërmjet postës elektronike njoftimi për plotësimin e “Formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit”, njoftim i cili i është dërguar edhe kryetarit të gjykatës z. Flamur Kapllani. Me shkresën nr. 5365 prot., datë 12.10.2022, është dërguar “Formulari i integruar i vlerësimit të gjyqtarit”, si dhe kopje e njësuar me origjinalin e vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim.

Në datën 19.09.2022, nëpërmjet shkresës me nr. 4910 prot., Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i është kërkuar informacion lidhur me të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit {...} gjatë periudhës së vlerësimit, vitet kalendarike 2017-2019. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kthyer përgjigje, lidhur me informacionin e kërkuar duke dërguar edhe aktet për trajtimin e ankesave, me shkresën nr. 2621/1 prot., datë 20.10.2022.

Në datën 19.09.2022, nëpërmjet shkresës me nr. 4910 prot., Shkollës së Magjistraturës i është kërkuar informacion lidhur me pjesëmarrjen dhe përfshirjen e gjyqtarit {...} në veprimtaritë trajnuese gjatë periudhës së vlerësimit, vitet kalendarike 2017-2019. Shkolla e Magjistraturës ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 123/7 prot., datë 06.02.2023, protokolluar në KLGJ me nr. 4910/8 prot., datë 06.02.2023.

Në datën 02.11.2022, nëpërmjet shkresës me nr. 5739 Prot., Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) i është kërkuar hartimi i kontrollit të deklaratave të pasurisë dhe interesave private për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2021, për të cilët ka filluar vlerësimi etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019, ndër ta edhe për z. {...}. ILDKPKI me shkresë nr.3349/2 prot., datë 18.11.2022, protokolluar në KLGJ me nr. 5739/1 prot, datë 01.12.2022 ka dërguar raportin përkatës.

Gjatë ecurisë së procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, ka rezultuar se Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin nr.{...},² datë 02.03.2023 ka vendosur:

1. *Ndryshimin e vendimit nr. {...}, datë {...} të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. {...}.*
2. *Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.*

¹Të dhënat statistikore për periudhën e vlerësimit 2017-2019 janë dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nëpërmjet postës elektronike në datat 04.10.2022, protokolluar në Këshill me nr. 5211 prot., datë 04.10.2022

² Publikuar në faqen zyrtare të Komisionit të Posaçëm të Apelit [{...}/](#)

Pas konstatimeve si më sipër, KVEVP në mbledhjen e datës 13.03.2023 ka shqyrtuar propozimin e relatores së procedurës së vlerësimit dhe ka vendosur të miratojë propozimin për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, të filluar ndaj gjyqtarit {...}, duke ia kaluar për shqyrtim çështjen Mbledhjes Plenare.

II. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

Neni 179/b, pika 7, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: *“Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë”*.

Neni 66, i ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se: *“Vendimi i Kolegjit të Apelimit, që vendos shkarkimin nga detyra, ka efekt të menjëhershëm ex lege”*.

Neni 164 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në dispozitat e tij kalimtare, parashikon se: *“1. Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse: ...b) kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*”

Këshilli ka miratuar vendimin nr. 263, datë 21.11.2019, “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, ku në nenin 7, parashikohet se: *“Kur Këshilli vendos mbarimin e statusit të një gjyqtari, për veprimtarinë e të cilit ka filluar vlerësimi etik dhe profesional, deklarohet përfundimi i procedurës së vlerësimit pa vendim përfundimtar”*.

III. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

Gjatë ecurisë së procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, ka rezultuar se gjyqtari {...} ka humbur statusin e magjistratit, për shkak të aplikimit të masës disiplinore të *“Shkarkimit nga detyra”*, dhënë me vendimin nr. {...}, datë {...} të Kolegjit të Posaçëm i Apelimit.

Ky sanksion i marrë nga organet e rivlerësimit kalimtar në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 164, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në dispozitat kalimtare të tij, passjell mbarimin e menjëhershëm të statusit të magjistratit.

Në vendimin e Këshillit nr. 263, datë 21.11.2019, “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, në nenin 7 të tij, përcaktohet se mbarimi i statutit të gjyqtarit përbën shkak për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të filluar ndaj gjyqtarit.

Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe situatën faktike të parashtruar më sipër, Këshilli vlerëson se procedura e vlerësimit të etik dhe profesional për ish/gjyqtarin {...}, e filluar me vendimin nr. 371, datë 13.09.2022, duhet të përfundojë pa vendim përfundimtar, për shkak se si objekti ashtu dhe qëllimi i kësaj procedure vlerësimi është bërë i pamundur për tu realizuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 61 pika 1, 63 dhe 86 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 66 të ligjit 84/2016” “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...}, për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit.
2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR